

Data 28/01/2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**Blerje oksigjen ndarë në lote, gjithsej 2 (dy) - Marrëveshje Kuadër me nje operator ekonomik--
ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 1 vjekar (12 muaj)**

**FONDI LIMIT : FONDI LIMIT 10,935,900(dhjetë milion nentëqind e tridhjetë e pesë mijë
e nentëqind) leke pa Tvsh**

Loti 1: Blerje oksigjen i gaztë

- Fondi limit/vlera e pritshme e kontrates 134,550 (njetëqind e tridhjetë e kater milion e pesëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa tvsh

LOT 2: Blerje oksigjen i lëngët

- Fondi limit/vlera e pritshme e kontrates 10,801,350 (dhjetë milion e teteqind e nje mijë e treqind e pesëdhjetë) lekë pa tvsh

-

KODI SIPAS FJALORIT TË PËRBASHKËT TË PROKURIMIT: Produkte farmaceutike

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Spitali Rajonal Elbasan ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Loti 1: Blerje oksigjen i gaztë

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

c. Formulari i ofertes ekonomike sipas Shtojces 1

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Operatori ekonomik duhet të disponoje kategori/nënkategori te vlefshme per prodhimin dhe/ose tregtimi të barnave të lëshuar nga QKL ose QKB

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Ligjit Nr. 105/2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, të ndryshuar, neni 28, pika 1 “Tregtimi me shumice i barnave” i cili parashikon qe tregtimi i barnave behet nga subjekte te licensuar:

”1. Tregtimi me shumicë I barnave kryhet nga importuesi, eksportuesi, shpërndarësi farmaceutik, që është person juridic ose fizik, tregtar, vendas ose I huaj, I pajisur me licencën përkatëse për këtë veprimtari, sipas legjislacionit përkatës për licencimin.si dhe

Ligjin nr 10081 date 23.02.2009 (indryshuar) “Per licensat, autorizimetdhelejet ne RSH”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës per secilin prej loteve / shumatores se loteve per te cilat konkuron**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Autoriteti Kontraktor ka konsideruar te nevojshme perfshirjen e kriterit te cituar me lart, ne menyre qe t'i shërbejë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë

pjesëmarrës të mundshëm si dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Bazuar në nenin 43 pika 2/b dhe pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet:

Neni 43 pika 2/b

Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar.

Neni 43 pika 5

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, te Ligjit Nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", I ndryshuar, ku përcaktohet: *Çdo tatimpagues pergatit deklaraten vjetore te te ardhurave te tatueshme ne formen e percaktuar ne udhezimin e Ministrit te Financave ne zbatim te ketij ligji.*

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Dëshmi nga operatori ekonomik për furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më e vogël se 20% e vlerës së fondit limit dhe **që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.**

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme me një ent publik, kërkohen **vërtetime të lëshuara nga një autoritet / ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës së bashku me kontratën e lidhur ose / dhe fatura tatimore të shitjes**, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm **fatura tatimore të shitjes**, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, **ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.**

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me piken 4 te nenit 77 te Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, "Per Prokurimin Publik" , ne te cilin gjejme te percaktuar se: *4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që*

garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; si dhe me piken 4 te nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ne te cilen eshte e percaktuar se: [...]4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Vendosja e këtij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine teknike te OE ofertues, nepermjet pervojave te duhura, qe jane ne perpjesetim me natyren e objektit te prokurimit dhe qe ka aftesine e duhur per zbatimin e kontrates sic eshte parashikuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe piken 4 te nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën sa **20 %** të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vendosja e këtij kriteri behet me qellim krijim te bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine teknike te OE ofertues, nepermjet pervojave te duhura, qe jane ne perpjesetim me natyren e objektit te prokurimit dhe qe ka aftesine e duhur per zbatimin e kontrates sic eshte parashikuar nga AK.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë origjinën e mallit dhe kompaninë prodhuese, kjo të plotësohet në Shtojcën 2. Listat e Çmimeve të artikujve të DST.

Argumentimi: Kjo kerkese vendoset me qëllim njohjen e origjinës së mallit dhe kompaninë prodhuese për të identifikuar në mënyrë të qartë atë gjatë lëvrimit të tij dhe për të pasur sigurinë që i njëjti mall i ofertuar do të lëvrohet në destinacion. Ky kriter është ne perputhje me nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, dhe keto kerkesa i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses te kontrates pra te garancisë së furnizimit të mallit objekt prokurimi.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- dokumenti i cili konfirmon se bari i ofertuar, është i pajisur me autorizim për tregtim në Republikën e Shqipërisë, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore

/ose/

- **autorizimi për tregtim i barit, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore**, brenda afatit të tij të vlefshmërisë.
- **Argumentimi:** Sigurimi i cilësisë dhe sigurisë së barnave, Ligji për barnat dhe pajisjet mjekësore në Republikën e Shqipërisë, ndër të tjera, vendos që barnat duhet të jenë të siguruara dhe të kalojnë procedurat e rregullta të kontrollit përpara se të vendosen në treg. Kjo garanci jepet përmes autorizimit nga AKBPM, i cili verifikon se produkti farmaceutik përmbush standardet e nevojshme të cilësisë, sigurisë dhe efektivitetit për përdoruesit. Legjitimiteti i tregtimit, Dokumenti që vërteton autorizimin për tregtim është një dëshmi e ligjshmërisë së ofrimit të barit në tregun shqiptar. Pa këtë dokument, një bar nuk mund të tregtohet në mënyrë të ligjshme në Shqipëri. Kriteri kërkon që operatori ekonomik të sigurojë një dokument për këtë autorizim, duke u siguruar që bari/rat e ofertuar janë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Afati i vlefshmërisë, Kërkesa që autorizimi të jetë brenda afatit të vlefshmërisë ka për qëllim të shmangë përdorimin e barnave që mund të kenë kaluar periudhën e tyre të certifikimit dhe të mos përmbushin më standardet e përcaktuara për sigurinë dhe efektivitetin. Për rrjedhojë, kjo kërkesë ndihmon në parandalimin e situatave ku mund të përdoren barna të papërshtatshme për konsum njerëzor.
- Në përfundim, ky kriter synon të garantojë që barnat e ofertuar janë të ligjshme, të sigurta dhe të certifikuara për përdorim në përputhje me legjislacionin shqiptar për barnat dhe pajisjet mjekësore, dhe përmbushin standardet e cilësisë së përcaktuara nga autoritetet përkatëse. Githashtu kriteri bazohet në ligjin Nr. 105/2014 “Për Barnat dhe Pajisjet Mjekësore” neni 8 neni 9 e vijues. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 299, datë 08.04.2015 “Për Miratimin E Rregullores Për Dhënien e Autorizimit të Tregtimit të Barnave e të Klasifikimit të Tyre në Republikën e Shqipërisë”; **Udhëzimi Nr. 1, datë 12.01.2015 i Ministrisë së Shëndetësisë**; Ligji Nr. 9902, datë 17.4.2008 “Për Mbrojtjen e Konsumatorëve”; Relacionin e grupit te punes per te rishikuar shkaqet e anulimit te procedures, percaktimin e kriterëve te vecanta per kualifikim dhe specifikimeve teknike. Me nr. 410/15 Prot datë 17.09.2024.

2.3.4 Kërkohe autorizim (i vlefshëm për periudhën 2025 - 2026), lëshuar nga MAH (mbajtësi i autorizimit të tregtimit), nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë barnat e tij në vendin tonë.

Argumentimi: Ky autorizim garanton që bari përmbush standardet e nevojshme të cilësisë dhe sigurisë, duke qenë i përshtatshëm për përdorim nga konsumatorët shqiptarë. Ligji Nr. 105/2014 “Për Barnat dhe Pajisjet Mjekësore” neni 8 Neni 9. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 299, datë 08.04.2015; Udhëzimi Nr. 1, datë 12.01.2015 i Ministrisë së Shëndetësisë; Rregulloret për MAH parashikojnë që një kompani farmaceutike ose ent tjetër që është mbajtës i autorizimit të tregtimit duhet të sigurojë që produktet e saj janë të regjistruara dhe të certifikuara për tregtinë në Shqipëri për periudhën e vlefshmërisë së kërkuar. Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 299, datë 08.04.2015, i cili përcakton procedurat për regjistrimin dhe autorizimin e barnave, operatorët ekonomikë duhet të sigurojnë që produktet e tyre janë të regjistruara dhe të mbikëqyrura nga autoritetet kompetente, në këtë rast AKBPM dhe MAH. Autorizimi i kërkuar për periudhën 2025-2026 garanton që produktet janë nën kontrollin e vazhdueshëm të këtyre autoriteteve dhe përmbushin standardet e përcaktuara ligjore.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese certifikimin **ISO 9001:2015** mbi “**Sistemet e menaxhimit të cilësisë**” në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentimi: Certifikimi me këto ISO siguron që furnizuesi ka sisteme të mirembajtura për të siguruar cilësinë e oksigjenit në përputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike. Duke patur parasysh objektin e prokurimit dhe ndikimin e lartë që ka në ndikimin e shëndetit certifikimi me këto ISO është një indikator i besueshmerisë dhe perkushtimit të furnizuesit për të ofruar produkte dhe shërbime cilësore. Përfshirja e certifikimit ISO 9001:2015 siguron që furnizuesi është në gjendje të përmbushë kërkesat e cilësisë, të menaxhojë rreziqet dhe të sigurojë një furnizim të qëndrueshëm dhe të besueshëm të oksigjenit. Kjo gjykohe se rrit transparencën dhe cilësinë e procesit të prokurimit.

2.3.6 Certifikate OHSAS 18001:2007, të vlefshme, për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë . Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë për fushën e aktivitetit të OE/ që perkon/ përputhet me objektin e Prokurimit

Argumentimi: OHSAS 18001:2007 është një standart ndërkombëtar për Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe sigurisë në punë, i cili ndihmon në menaxhimin dhe minimizimin e rreziqeve të shëndetit dhe sigurisë në vendin e punës. Duke kërkuar këtë certifikim sigurohet që furnizuesi të ndjekë standarte të larta sigurie dhe të minimizojë rreziqet që mund të ndikojnë në furnizimin e oksigjenit duke përfshirë përpunimin, ruajtjen dhe dorezimin.

2.3.7 Certifikatë ISO 14001:2015 –Sistemi i menaxhimit mjedisor ose ekuivalent, të vlefshme, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, për fushën e aktivitetit të OE/ që perkon/ perputhet me objektin e Prokurimit.

Argumentimi: Ky certifikim është një standart ndërkombëtar për sistemin e menaxhimit të mjedisit i cili siguron që furnizuesit mund të menaxhojnë dhe të marrin masa për minimizimin e ndikimeve në mjedis . Kërsesa për certifikim garantohej nga nevojat për të minimizuar ndikimet mjedisore , për të siguruar përputhshmërinë ligjore , për të mbështetur qëndrueshmërinë e zinxhirit të furnizimit. Ky certifikim ndihmon gjithashtu në reduktimin e rreziqeve lidhur me menaxhimin mjedisor .

Argumentimi Ligjor: Kërkesa për pikat e mësipërme 2.3.5,2.3.6,2.3.7 është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, pika 3,4 të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se zotërojnë Certifikatat përkatëse që i mundëson Autoritetit Kontraktor për të verifikuar dhe krijuar besimin që OE ofertues është në gjendje të realizojë punën /shërbimin në mënyrë cilësore që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje dhe në rekomandimin e APP dhe Drejtorise se përgjithshme të Akreditimit nr. 3330 prot, date 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, date 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilësive”.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të disponojë minimumi 25 bombola oksigjeni mjeksor / pako bombola, në pronësi ose me qira.

Për bombola në pronësi duhet të paraqesë:

- ✚ Dokument që vërteton pronësinë e tyre (aktet e zhdoganimit në Republikën e Shqipërisë /faturat tatimore të blerjes/ ose cdo document sipas legjislacionit në fuqi).

Për bombola me qira duhet të paraqesë:

- ✚ Kontrata përkatëse noteriale e qirasë, shoqëruar me dokumentin që vërteton regjistrimin e bombulave (aktet e zhdoganimit në Republikën e Shqipërisë /faturat tatimore të blerjes/ ose cdo document sipas legjislacionit në fuqi).

*Kriteri konsiderohet i permbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DST **ku të specifikohen pikat e mësipërme.**, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

Argumentim teknik: Oksigjeni është një gaz që mund të jetë i rrezikshëm nëse nuk ruhet dhe transportohet në kushte të sigurisë. Bombulat oksigjeni janë dizajnuar për të ruajtur oksigjenin në kushte të sigurta dhe të qëndrueshme, duke parandaluar çdo rrezik të mundshëm që mund të shkaktohet nga gazra të pa ruajtur mire. Bombulat oksigjeni janë veçanërisht të përshtatshme për përdorim në situata emergjente, kur mund të ketë nevojë për oksigjen të shpejtë dhe të menjëhershëm në vend. Ato mund të transportohen lehtësisht në vende ku kërkohet oksigjen i menjëhershëm jetik në shërbim të pacientëve. Duke kërkuar bombula oksigjeni, sigurohet që

kapaciteti i nevojshëm i oksigjenit të jetë gjithmonë i disponueshëm dhe i gatshëm për përdorim. Përdorimi i bombulave gjithashtu mund të ndihmojë në menaxhimin më të mirë të furnizimeve dhe ndihmon në planifikimin e nevojave për oksigjen gjatë periudhave të pikut. Kjo kerkese mund të sigurojë që oksigjeni që përdoret është në përputhje me rregulloret dhe standardet e industrisë për cilësinë dhe sigurinë e gazit. Gjithashtu Ak ne keto kushte mund të krijojë një menaxhim më të mirë të burimeve dhe të sigurojë që stoku të jetë i mjaftueshëm për periudha të ndryshme të përdorimit, duke ulur rrezikun e mungesës dhe mundësuar përdorim efektiv.

Argumentimi: Ky kriter vendoset ne mbeshtetje te pikes 2 dhe 4 te nenit 77 te Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik” dhe behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine teknike te OE ofertues, nepermjet pasjes se burimeve/kapaciteteve te mjaftueshme per furnizimin me sasine dhe llojin e kerkuar nga AK dhe qe ka aftesine e duhur per zbatimin e kontrates sic eshte parashikuar ne DST.

2.3.9 Operatori ekonomik per bombolat e pikës 2.3.8 duhet te paraqesë vertetimin e kryerjes se kontrolleve periodike te **Inspektorati Shteteror Teknik dhe Industrial** (Drejtoria e Inspektimit te Pajisjeve nen Presion) ose/ **organet kompetente për regjistrimin, kontrollin e kushteve teknike dhe te sigurisë, per enët nën presion tankera/serbatore/cisterna**, sipas percaktimeve ligjore i vlefshem gjate periudhës se ekzekutimit te kontratës ku të jene përcaktuar numri dhe kapaciteti i tyre, data e kontrollit, organi inspektues dhe plotesimi i standarteve, kushteve teknike dhe te sigurisë.

Argumentimi:

Argumentimi: Ky kriter vendoset ne mbeshtetje te pikes 2 dhe 4 te nenit 77 te Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik” dhe behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine teknike te OE ofertues, nepermjet pasjes se burimeve/kapaciteteve te mjaftueshme per furnizimin me sasine dhe llojin e kerkuar nga AK dhe qe ka aftesine e duhur per zbatimin e kontrates sic eshte parashikuar ne DST.

LOT 2: Blerje oksigjen i lëngët

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

c. *Formulari i ofertes ekonomike sipas Shtojces 1*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.1.1 Operatori ekonomik duhet të disponoje kategori/nënkategori të **vlefshme per prodhimin dhe/ose tregtimi të barnave** të lëshuar nga QKL ose QKB

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Ligjit Nr. 105/2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, të ndryshuar, neni 28, pika 1 “Tregtimi me shumice i barnave” i cili parashikon që tregtimi i barnave behet nga subjekte te licensuar:

*”1. Tregtimi me shumicë I barnave kryhet nga importuesi, eksportuesi, shpërndarësi farmaceutik, që është person juridic ose fizik, tregtar, vendas ose I huaj, **I pajisur me licencën përkatëse për këtë veprimtari, sipas legjislacionit përkatës për licencimin.**si dhe*

Ligjin nr 10081 date 23.02.2009 (indryshuar) “Per licensat, autorizimetdhelejet ne RSH”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës per secilin prej loteve / shumatores se loteve per te cilat konkuron**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Autoriteti Kontraktor ka konsideruar te nevojshme perfshirjen e kriterit te cituar me lart, ne menyre qe t'i shërbejë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të mundshëm si dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Bazuar në nenin 43 pika 2/b dhe pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet:

Neni 43 pika 2/b

Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar.

Neni 43 pika 5

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, te Ligjit Nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", I ndryshuar, ku përcaktohet: *Çdo tatimpagues pergatit deklaraten vjetore te te ardhurave te tatueshme ne formen e percaktuar ne udhezimin e Ministrit te Financave ne zbatim te ketij ligji.*

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Dëshmi nga operatori ekonomik për furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më e vogël se 20% e vlerës së fondit limit dhe **që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.**

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme me një ent publik, kërkohen **vërtetime të lëshuara nga një autoritet / ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës së bashku me kontratën e lidhur ose / dhe fatura tatimore të shitjes**, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm **fatura tatimore të shitjes**, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, **ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.**

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me piken 4 te nenit 77 te Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, "Per Prokurimin Publik", ne te cilin gjejme te percaktuar se: 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; si dhe me piken 4 te nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", ne te cilin eshte e percaktuar se: [...]4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvojave të duhura, që janë në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës sic është parashikuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 4 të nenit 40 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën sa **20 %** të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim krijim të bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvojave të duhura, që janë në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës sic është parashikuar nga AK.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë origjinën e mallit dhe kompaninë prodhuese, kjo të plotësohet në Shtojcën 2. Listat e Çmimeve të artikujve të DST.

Argumentimi: Kjo kërkesë vendoset me qëllim njohjen e origjinës së mallit dhe kompaninë prodhuese për të identifikuar në mënyrë të qartë atë gjatë lëvrimin të tij dhe për të pasur sigurinë që i njëjti mall i ofertuar do të lëvrohet në destinacion. Ky kriter është në përputhje me nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, dhe kjo kërkesë i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës pra të garancisë së furnizimit të mallit objekt prokurimi

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- dokumenti i cili konfirmon se bari i ofertuar, është i pajisur me autorizim për tregtim në Republikën e Shqipërisë, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore
/ose/
- autorizimi për tregtim i barit, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, brenda afatit të tij të vlefshmërisë.
- **Argumentimi:** Sigurimi i cilësisë dhe sigurisë së barnave, Ligji për barnat dhe pajisjet mjekësore në Republikën e Shqipërisë, ndër të tjera, vendos që barnat duhet të jenë të

siguruara dhe të kalojnë procedurat e rregullta të kontrollit përpara se të vendosen në treg. Kjo garanci jepet përmes autorizimit nga AKBPM, i cili verifikon se produkti farmaceutik përmbush standardet e nevojshme të cilësisë, sigurisë dhe efektivitetit për përdoruesit. Legjitimiteti i tregtimit, Dokumenti që vërteton autorizimin për tregtim është një dëshmi e ligjshmërisë së ofrimit të barit në tregun shqiptar. Pa këtë dokument, një bar nuk mund të tregtohet në mënyrë të ligjshme në Shqipëri. Kriteri kërkon që operatori ekonomik të sigurojë një dokument për këtë autorizim, duke u siguruar që bari/rat e ofertuar janë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Afati i vlefshmërisë, Kërkesa që autorizimi të jetë brenda afatit të vlefshmërisë ka për qëllim të shmangë përdorimin e barnave që mund të kenë kaluar periudhën e tyre të certifikimit dhe të mos përmbushin më standardet e përcaktuara për sigurinë dhe efektivitetin. Për rrjedhojë, kjo kërkesë ndihmon në parandalimin e situatave ku mund të përdoren barna të papërshtatshme për konsum njerëzor.

- Në përfundim, ky kriter synon të garantojë që barnat e ofertuar janë të ligjshme, të sigurt dhe të certifikuar për përdorim në përputhje me legjislacionin shqiptar për barnat dhe pajisjet mjekësore, dhe përmbushin standardet e cilësisë së përcaktuara nga autoritetet përkatëse. Githashtu kriteri bazohet në ligjin Nr. 105/2014 “Për Barnat dhe Pajisjet Mjekësore” neni 8 neni 9 e vijues. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 299, datë 08.04.2015 “Për Miratimin E Rregullores Për Dhënien e Autorizimit të Tregtimit të Barnave e të Klasifikimit të Tyre në Republikën e Shqipërisë”; **Udhëzimi Nr. 1, datë 12.01.2015 i Ministrisë së Shëndetësisë**; Ligji Nr. 9902, datë 17.4.2008 “Për Mbrojtjen e Konsumatorëve”; Relacionin e grupit të punës për të rishikuar shkaqet e anulimit të procedurës, përcaktimin e kriterëve të vecanta për kualifikim dhe specifikimeve teknike. Me nr. 410/15 Prot datë 17.09.2024.

2.3.4 Kërkohet Autorizim (i vlefshëm për periudhën 2025 - 2026), lëshuar nga MAH (mbajtësi i autorizimit të tregtimit), nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë barnat e tij në vendin tonë.

Argumentimi: Ky autorizim garanton që bari përmbush standardet e nevojshme të cilësisë dhe sigurisë, duke qenë i përshtatshëm për përdorim nga konsumatorët shqiptarë. Ligji Nr. 105/2014 “Për Barnat dhe Pajisjet Mjekësore” neni 8 Neni 9. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 299, datë 08.04.2015; Udhëzimi Nr. 1, datë 12.01.2015 i Ministrisë së Shëndetësisë; Rregulloret për MAH parashikojnë që një kompani farmaceutike ose ent tjetër që është mbajtës i autorizimit të tregtimit duhet të sigurojë që produktet e saj janë të regjistruara dhe të certifikuar për tregtim në Shqipëri për periudhën e vlefshmërisë së kërkuar. Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 299, datë 08.04.2015, i cili përcakton procedurat për regjistrimin dhe autorizimin e barnave, operatorët ekonomikë duhet të sigurojnë që produktet e tyre janë të regjistruara dhe të mbikëqyrura nga autoritetet kompetente, në këtë rast AKBPM dhe MAH. Autorizimi i kërkuar për periudhën 2025-2026 garanton që produktet janë nën kontrollin e vazhdueshëm të këtyre autoriteteve dhe përmbushin standardet e përcaktuara ligjore.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese certifikimin **ISO 9001:2015** mbi “**Sistemet e menaxhimit të cilësisë**” në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

2.3.6 Certifikate OHSAS 18001:2007, te vlefshme, per sistemin e menaxhimit te shendetit dhe sigurise ne punë . Certifikata te jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë per fushen e aktivitetit te OE/ qe perkon/ perputhet me objektin e Prokurimit

2.3.7 Certifikatë ISO 14001:2015 –Sistemi i menaxhimit mjedisor ose ekuivalent, të vlefshme, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, per fushen e aktivitetit te OE/ qe perkon/ perputhet me objektin e Prokurimit.

Argumentimi:Kërkesa per pikat e mësipërme 2.3.5,2.3.6,2.3.7 është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, pika 3,4 të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se zotërojnë Certifikatat përkatëse që i mundëson Autoritetit Kontraktor për të verifikuar dhe krijuar besimin që OE ofertues është në gjendje të realizojë punën /shërbimin në mënyrë cilësore që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje dhe ne rekomandimin e APP dhe Drejtorise se pergjithshme te Akreditimit nr. 3330 prot, date 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, date 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kerkesave te cilesise”.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet te vetedeklaroje se gjate gjithe kohes se afatit te MK, do te kete gjendje brenda territorit të Shqipërisë një sasi rezerve oksigjeni mjeksor te lengshem, jo me pak se 3.000 litra, per mbulimin e nevojave emergjente të spitaleve. Duke qene se oksigjeni i lengshem eshte jetik, dhe sherben si terapi per pacientet, dhe per te garantuar vazhdimesine me furnizim ne rast te ndonje suate te jashtezakonshme (pandemi, problem ne fabriken e prodhimit, etj.), duhet qe subjekti duhet te kete sasi rezerve per furnizim per minimumi 15 dite.

*Kjo sasi Percaktohet duke iu referuar konsumit minimal mesatar mujor

Argumentimi:Ky kriter vendoset ne mbeshtetje te pikes 2 dhe 4 te nenit 77 te Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik” dhe behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine teknike te OE ofertues, nepermjet pasjes se burimeve/kapaciteteve te mjaftueshme per furnizimin me sasine dhe llojin e kerkuar nga AK dhe qe ka aftesine e duhur per zbatimin e kontrates sic eshte parashikuar ne DST.

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të provojë se në se shpallet fitues, është në gjendje të sigurojë tanker oksigjeni për ta instaluar brenda 10 diteve nga lidhja e kontrates, pranë Autoritetit Kontraktor. Kërkohej 1 tanker sipas nevojave aktuale të spitalit

Per tankerin ne pronësi duhet të paraqesë:

- ✚ Dokument që vërteton pronësinë e tyre (aktet e zhdoganimit në Republikën e Shqipërisë /faturat tatimore të blerjes/ ose cdo document sipas legjislacionit në fuqi).

Për tankerin me qera duhet të paraqesë:

- ✚ Kontrate përkatëse notoriale e qirasë, shoqëruar me dokumentin që vërteton regjistrimin e bombulave (aktet e zhdoganimit në Republikën e Shqipërisë /faturat tatimore të blerjes/ ose cdo document sipas legjislacionit në fuqi).

*Kriteri konsiderohet i permbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DST **ku të specifikohen pikat e mësipërme.**, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

Argumentimi: Ky kriter vendoset në mbështetje të pikës 2 dhe 4 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik” dhe behet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësi teknike të OE ofertues, nëpërmjet pasjes së burimeve/kapaciteteve të mjaftueshme për furnizimin me sasinë dhe llojin e kërkuar nga AK dhe që ka aftësi e duhur për zbatimin e kontrates sic është parashikuar në DST.

2.3.10 Operatori ekonomik për tankerat e pikës 2.3.9 duhet të paraqesë vërtetimin e kryerjes së kontrolleve periodike të **Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial** (Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve nën Presion) ose/ **organet kompetente për regjistrimin, kontrollin e kushteve teknike dhe të sigurisë, për enët nën presion tankera/serbatore/cisterna**, sipas përcaktimeve ligjore i vlefshëm gjatë periudhës së ekzekutimit të kontratës ku të jenë përcaktuar numri dhe kapaciteti i tyre, data e kontrollit, organi inspektues dhe plotësimi i standarteve, kushteve teknike dhe të sigurisë.

Argumentimi: Ky kriter vendoset në mbështetje të pikës 2 dhe 4 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik” dhe behet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësi teknike të OE ofertues, nëpërmjet pasjes së burimeve/kapaciteteve të mjaftueshme për furnizimin me sasinë dhe llojin e kërkuar nga AK dhe që ka aftësi e duhur për zbatimin e kontrates sic është parashikuar në DST.

2.3.11 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë se nëse është e nevojshme se nga periudha e nënshkrimit të kontrates deri në instalimin e tankerit duhet të furnizojë AK përfitues me bombula oksigjeni mjeksor të gazte i cili do të konvertohet me sasinë e Oksigjeni mjeksor të lëngët. Oksigjeni mjeksor gaz i përdorur në bombula duhet të jetë i regjistruar pranë AKBPM.

Argumentimi: Ky kriter vendoset në mbështetje të pikës 2 dhe 4 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik” dhe behet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësi teknike të OE ofertues, nëpërmjet pasjes së burimeve/kapaciteteve të

mjaftueshme per furnizimin me sasine dhe llojin e kerkuar nga AK dhe qe ka aftesine e duhur per zbatimin e kontrates sic eshte parashikuar ne DST.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Argumentimi i Specifikimeve Teknike

Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

Specifikimi i Materialeve:

Blerje oksigjen I gazte

1. Oksigjen i gazet

Oksigjen	O ₂	Jo me pak se 99,70 %
Monoksid karboni	CO	Jo me shume se 0.13 vmp (volum për milion)
Bioksid Karboni	CO ₂	Jo me shume se 0.11 vpm
Ujë	H ₂ O	Jo me shume se 0.06 vpm

Te mos permbajne elemente te tjere kristaline

Furnizimi do behet me bombola 10 deri 40 litra me presion deri ne 125 bar.

Operatori duhet te garantoje mbajtjen e nje sasie rezerve brenda vendit, 25 bombola, minimalisht per nevojat 30 ditore, ne varesi te vellimit te nje bombule.

Ambalazhimi i oksigjenit për përdorim mjeksor të jetë në bombulat e OE

Bombulat të kenë shenjën dalluese “ për përdorim spitalor” (O₂)

Kushtet e furnizimit.

Bombolat e oksigjenit duhet të shoqërohen me vërtetimin e kryerjes së kontrolleve periodike të **Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial** (Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve nën Presion) ose/ **organet kompetente për regjistrimin, kontrollin e kushteve teknike dhe të sigurisë, për enët nën presion tankera/serbatorë/cisterna**, sipas përcaktimeve ligjore.

Transporti i bombolave të oksigjenit mjekësor, i kompresuar, duhet të bëhet me automjete të pajisur me :

- Leje për Transport gazra mjekësore nën presion, të lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial.
- Leje për Transport gazra mjekësore nën presion të lëshuar nga MNZSH.
- Certifikatë miratimi ADR të lëshuar nga DPSHTRR.
- Transportimi dhe shkarkimi i mallit është përgjegjesi e shitesit
- Furnizimi bëhet sipas kërkesave dhe nevojave faktike të Autoritetit Kontraktor për këtë artikull, bazuar në kontratat e lidhura gjatë gjithë periudhës së vlefshmerisë së Marrveshjes Kuadër.

Për arsye të krijimit të një sigurie në kryerjen e furnizimit pa krijuar vonesa dhe mbulimin në kohe dhe pa probleme të nevojave për oksigjen nisur dhe nga përvojat e mëparshme, Autoriteti Kontraktor do të lidhe me operatorin ekonomik fitues të dalë nga procedura e prokurimit, kontratë bazuar në nevojat e Autoritetit Kontraktor.

Shënim: Oksigjeni i bombolave që do të përdoren duhet të jetë i regjistruar në AKBPM për tregtim në Republikën e Shqipërisë.

Lot 2 Blerje oksigjen Leng

Specifikimet teknike

1 – Oksigjeni për përdorim mjekësor duhet të jetë

Oksigjen	O ₂	Jo më pak se 99,70 %
Monoksid karboni	CO	Jo më shumë se 0.13 vmp (volum për milion)
Bioksid Karboni	CO ₂	Jo më shumë se 0.11 vpm
Ujë	H ₂ O	Jo më shumë se 0.06 vpm

- Kërkesat për furnizimin janë si më poshtë

Kushtet e furnizimit

Automjetet

Furnizimi të bëhet me autobotët e furnizuesit të pajisur me :

- Leje për Transport gazra mjekësore nën presion, të lëshuar nga Inspektoriati Shteteror Teknik dhe Industrial.
- Leje për Transport gazra mjekësore nën presion të lëshuar nga MNZSH.
- Certifikatë miratimi ADR të lëshuar nga DPSHTRR.

Kërkesa të veçanta

Mbështetur në detyrimin për të furnizuar mallin (oksigenin i lëngët) të ambalazhuar sipas kushteve teknike, Operatori Ekonomik duhet të furnizojë dhe montojë pranë AK, 1 tanker , i cili do të jetë në përdorim të AK deri në përfundimin e Marrëveshjes Kuadër.

Operatori Ekonomik është përgjegjës për pajisjen e Ak me tanker, montimin, lidhjen e tij me rrjetin e oksigjenit të spitalit, kontrollin dhe mirembajtjen në përputhje me kushtet teknike dhe legjislativën në fuqi.

Brenda 30 ditëve nga lidhja e Minikontrates në bazë të Marrëveshjes Kuadër , Operatori Ekonomik fitues, në marrëveshje me AK, duhet të realizojë furnizimin dhe montimin e tankerit pranë AK. Pas instalimit të tankerit, OE fitues duhet të kryejë rregjistrimin dhe certifikimin e tij pranë **Inspektoratit Shteteror Teknik dhe Industrial**.

Për periudhën e zgjatjes së punimeve, kontraktori duhet të marrë masat për të mos ndërprerë furnizimin me oksigjen të shërbimeve spitalore, duke furnizuar më parë me oksigjen të gaztë me bombola 10-40 litra me presion 125 bar, sipas nevojave të spitalit. Sasia e oksigjenit mjeksor të gaztë të konsumuar gjatë ditëve të instalimit të tankerave do të konvertohet në oksigjen të lëngët sipas normativave teknike.

Operatori ekonomik duhet të sigurojë, në rast avarie të tankerit të oksigjenit lëng, furnizimin me tanker rezervë ose me bombola oksigjeni mjeksor gaz, për të siguruar gadishmërinë e furnizimit me oksigjen të shërbimeve spitalore. Sasia e oksigjenit mjeksor të gaztë të konsumuar gjatë kësaj periudhe do të konvertohet në oksigjen të lëngët sipas normativave teknike.

Për arsye të krijimit të një sigurie në kryerjen e furnizimit pa krijuar vonesa dhe mbulimin në kohë dhe pa probleme të nevojave për oksigjen nisur dhe nga përvojat e mëparshme, Autoriteti Kontraktor do të lidhet me operatorin ekonomik fitues të dalë nga procedura e prokurimit, kontratë bazuar në nevojat e Autoritetit Kontraktor.

Tankerat e Oksigjenit

Tankerat duhet të certifikohen nga **Inspektorati Shteteror Teknik dhe Industrial** (Drejtoria e Inspektimit te Pajisjeve nen Presion) dhe duhet ti nënshtrohen inspektimeve sipas afateve të përcaktuara ligjore.

Furnizimi dhe depozitimi i Oksigjenit të lëngët do të bëhet në përputhje me kushtet teknike dhe të sigurisë, në tankerat e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor.

-Kapaciteti i Tankerit jo me pak se 10 000 litra për godinën e Spitalit i cili të paiset me litërmatës 5 shifror

Gaz per perdorim mjeksor, i lengshem:

Nr.	Institucioni	Nr. i tankereve	Kapaciteti ne litra	Pronesia	Vend ndodhja
1	Spitali Rajonal Elbasan	1	5,000	Pronesi e spitalit	Ne ambientet e spitalit
		1	15000	Pronesi e operatorit e konomik	Ne ambientet e spitalit

Operatori Ekonomik duhet te furnizojë dhe montojë pranë AK, tankerat te cilat do te jene ne përdorim te institucionit spitalor deri ne nderrimin e tankerit nga operatori tjetër pas perfundimit te marreveshjes kuader.

OE ka detyrimin per certifikimin e Tankerave në Inspektoriatin Shteteror Teknik dhe Industrial (Drejtoria e Inspektimit te Pajisjeve nen Presion), rregjistrimin dhe ndjekjen e kryerjes se inspektimeve sipas afateve te percaktuara ligjore.

.Aparatet matese te depoziatave/tankerave te jene te kolauduara nga institucionet kompetente. Me lidhjen e MK, ti vihet dokumentacioni i kolaudimit te aparatave matese, grupit te punes te marrjes ne dorezim te mallit nga OE.

Shenim: Oksigjeni i bombolave qe do te perdoren duhet te jete i regjistruar ne AKBPM per tregtim ne Republikën e Shqiperise.

Bombolat e oksigjenit duhet te shoqerohen me vertetimin e kryerjes se kontrolleve periodike te **Inspektorati Shteteror Teknik dhe Industrial** (Drejtoria e Inspektimit te Pajisjeve nen Presion) ose/ **organet kompetente për regjistrimin, kontrollin e kushteve teknike dhe te sigurisë, per enët nën presion tankera/serbatore/cisterna**, sipas percaktimeve ligjore.

Bombolat e oksigjenit duhet te shoqerohen me vertetimin e kryerjes se kontrolleve periodike te **Inspektorati Shteteror Teknik dhe Industrial** (Drejtoria e Inspektimit te Pajisjeve nen Presion) ose/ **organet kompetente për regjistrimin, kontrollin e kushteve teknike dhe te sigurisë, per enët nën presion tankera/serbatore/cisterna**, sipas percaktimeve ligjore.

Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje apo hapjen e tyre :

Data: 18.02.2025 ora 10.00

NJESIA E PROKURIMIT